# SHPARTALLOHET MAFIA E "ALBPETROLIT"

**Nga Gentjan Ruko**
**"Koha Jonë", e premte, 12 tetor 2001**

*Policia e Fierit arrin suksesin e radhës në operacionet për zbulimin e vjedhjes së naftës dhe gazit. Këtë herë 10 persona kanë rënë në pranga, mes të cilëve 6 janë funksionarë të ndërmarrjes. Ndërsa numri i përgjithshëm i personave nën hetim shkon në 29. Të gjithë janë të përfshirë në vjedhjen galopante të gazit nga puset e naftës për ta përdorur në furrat e shkrirjes së gëlqeres.*

**FIER** - Intensifikohen goditjet mbi mafian e naftës. Dje, një operacion i policisë së Fierit është ndërmarrë në vendburimin e naftës në Marinëz dhe 10 vetë janë prangosur për vjedhje të gazit nga puset shtetërore të prodhimit të naftës. Ndër të arrestuarit, 6 janë funksionarë të ndërmarrjes, çka tregon se për herë të parë po fillojnë të tronditen themelet e një korrupsioni të madh, që nuk mund të kryehet pa dijeninë e zyrtarëve të kompanisë së "Albpetrolit". Në birucë kanë përfunduar dje edhe 4 privatë që vidhnin gazin për ta përdorur si lëndë të parë për prodhimin e gëlqeres. Së bashku edhe me 19 punëtorë të ndërmarrjes, të cilët ndiqen në gjendje të lirë, shkon kështu në 29 numri i personave të penalizuar për vjedhjen e gazit.

Për shpërdorim detyre akuzohen përgjegjësit e ndërresës në 4 puse nafte: Thoma Mato, Kastriot Lisi, Dhimitër Prifti, Bardhi Shpata dhe Viktor Dhanili. Ata kanë për detyrë të mirëadministrojnë puset e naftës, por nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Kanë mbyllur sytë kur privatët e quajtur Kastriot Ruko, Jetmir Plaka, Ajet Plaka dhe Bardhi Demo, tubacionin me gaz që duhet të mbërrinte në depot e dekantimit (ku nafta ndahet nga gazi), e kishin devijuar dhe linja kishte përfunduar në disa gropa ku piqej gëlqerja për t'u shitur. Privatët shkarkonin makina me gurë gëlqerorë, që i merrnin në Berat. Dhe pranë puseve të naftës kishin krijuar furra që përdornin gazin metan (të vjedhur nga puset) si lëndë e parë. Furrat e gëlqeres konsumonin rreth 1 mijë metra kub gaz në muaj e barasvlefshme kjo me 1 ton naftë. Dhe bëhet fjalë për vjedhje që vazhdonte për vite të tëra nën hundën e autoriteteve që heshtnin, në mos bashkëpunonin me vjedhësit.

Xhavit Shala, drejtori i policisë së Fierit, tha dje për "KJ" se operacioni është duke vazhduar dhe ai do të thellohet.

Operacioni kundër mafias së naftës filloi në muajin maj, kur iu vunë prangat presidentit të një firme të tregtimit të karburanteve në Ballsh, Nuri Rexha, i cili, për vite me radhë, ngarkonte bote të panumërt me naftë shtetërore të vjedhur për t'u shitur. Nafta vidhej nëpërmjet një tubacioni të nëndheshëm që ishte lidhur me tubacionin kryesor që transportonte arin e zi nga kombinati i naftës drejt puseve të naftës për të lehtësuar nxjerrjen e naftës së trashë. Më pas, dy presidentë të

tjerë firmash u arrestuan po për një vjedhje të tillë dhe 2 bashkëpunëtorë të tyre janë shpallur persona në kërkim.


# KOHA JONE

E përditshme e pavarur ... E premte, 12 tetor 2001

Policia e Fierit arrin suksesin e radhës në operacionet për zbulimin e vjedhjes së naftës dhe gazit. Këtë herë 10 persona kanë rënë në pranga, mes të cilëve 6 janë funksionarë të ndërmarrjes. Ndërsa numri i përgjithshëm i personave nën hetim shkon në 29

## HAJDUTË ME POSTE

## Shpartallohet mafia e Albpetrolit

Faqe 9

Ajet Plaka i arrestuar për vjedhje

Kastriot Lisi, 44 vjeç, Zharrës, përgjegjës sektori

Thoma Mata, 47 vjeç, përgjegjës sektori

Bardhyl Shpata, 35 vjeç, përgjegjës sektori në Marinëz

Dhimitraq Prifti, 33 vjeç, përgjegjës sektori në Marinëz

### Berisha, "me pranga" evropiane drejt parlamentit

### Antikorrupsioni, nga peshqit e vegjël tek të mëdhenjtë

ROLAND QAFOKU

Sot në rubrikën "Fate dhe Njerëz":

**"Malazezët më mbajnë peng burrin"**

Historia e marinarit Besnik Verboci nga Durrësi, i zhdukur në det gati tre vjet më parë, por që gruaja e tij beson se duhet të jetë gjallë.

**NË BRENDËSI**

Pack për zgjedhjet: "Ajo që ndodhi s'ishte e ndershme, por u bë" faqe 4

Nano dhe Meta takohen në Athinë faqe 3

Zona 98 dhe kulisat politike për kandidatët konkurentë faqe 2

Minë speciale për rrëzimin e shtyllave faqe 5

Albanian Airlines OFERTE SPECIALE ROME 259$ FRANKFURT 259$ BOLONIA 259$

WESTERN UNION
Dërgesat më të shpejta të parave nga e gjithë bota
Tel: (04) 23 49 79

ATLANTIK Kompani Sigurimesh
Fuqia juaj e sigurimeve
Tel: 00 355 4 253 586

# Aktualiteti

*Xhavit Shala, drejtori i policisë së Fierit, tha dje për "KJ" se operacioni është duke vazhduar dhe ai do të thellohet. Operacioni kundër mafios së naftës filloi në muajin maj, kur iu vunë prangat presidentit të një firme të tregtimit të karburanteve në Ballsh, Nuri Rexha, i cili për vite me radhë ngarkonte bote të panumërt me naftë shtetërore të vjedhur për t'u shitur.*



Ajet Plaka i arrestuar për vjedhje



Kastriot Lisi, 44 vjeç, Zharrëe, përgjegjës sektori



Thoma Mata, 47 vjeç, përgjegjës sektori



Bardhyl Shpata, 35 vjeç, përgjegjës sektori në Marinëz



Dhimitraq Prifti, 33 vjeç, përgjegjës sektori në Marinëz

# Shpartallohet mafia e "Albpetrolit"

*Policia e Fierit arrin suksesin e radhës në operacionet për zbulimin e vjedhjes së naftës dhe gazit. Këtë herë 10 persona kanë rënë në pranga, mes të cilëve 6 janë funksionarë të ndërmarrjes. Ndërsa numri i përgjithshëm i personave nën hetim shkon në 29. Të gjithë janë të përfshirë në vjedhjen galopante të gazit nga puset e naftës për ta përdorur në furrat e shkrirjes së gëlqeres*





